

**AKT THEMELIMI**  
**I**  
**SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**“ AGROTURIZEM RRAHMANI ” SH.P.K**

Sot, më datë 28/03/2023 (dy mijë e njezet e tre), **Z Bashkim Rrahmani**, shtetas shqiptarë, i datëlindjes 01/10/1973, lindur në Tirane(Selbe), dhe banues në Tirane Dajt bizes 03900023 nd 6 h 1, person madhor e me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i kartes me id H31001042P

Z. Flogert Rrahmani shtetas shqiptar, i datëlindjes 26/01/1985, lindur në Tirane (Selbe), dhe banues në Tirane Dajt fshati Selbe nd 0, person madhor e me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i kartes me id I50126046P.

**Z.Hasan Rrahmani**, shtetas shqiptar, i datëlindjes 31/12/1943, lindur nëTirane (Selbe), dhe banues në Tirane ne fshatin Dajt qafe Molle nd 26 h 1, person madhor e me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i kartes me id E31231062V

Vendosem te themelojme nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar sipas legjislacionit shqiptar dhe ne perputhje me dispozitat vijuese.

**NENI 1**  
**Themelimi**

Emri i shoqerise eshte **AGROTURIZEM RRAHMANI Sh.P.K**, Në të gjitha aktet që do të nxjerrë shoqëria kundrejt të tretëve si dhe në të gjitha aktet e brendshme të saj, do të shënohet detyrimisht emri” **AGROTURIZEM RRAHMANI“ SH.P.K**, sipas përcaktimeve të bera në këtë Akt Themelimi dhe Statut.

**NENI 2**

Qëllimi i krijimit të Shoqërisë.

Qëllimi i krijimit të kësaj Shoqërie eshte ndertimi dh zhvillimi I agroturizmit, bujtinave dhe cdo aktivitet tjetër I lidhur me kete fushe .

**NENI 3**  
**Emri dhe vula e shoqërisë**

Shoqëria, do të dalë në qarkullimin juridiko-civil me emrin " **AGROTURIZEM RRAHMANI** " **SH.P.K**. Ajo do të ketë edhe vulën e saj.

**NENI 4**  
**Objekti i veprimtarisë**

Veprimtaria e shoqërisë është: Ndertim dhe zhvillim agroturizem dhe bujtinave dhe restoranteve si dhe aktivitete te tjera te lidhura me kete sektor dhe cdo operacion te ngjashem dhe te lejuar nga legjislacioni shqiptarë

**NENI 5**  
**Selia e Shoqërisë dhe Afati**

Selia e Shoqërisë ndodhet në bashkinë Tirane , Adresa Tirane Dajt lagja qaf molle , rruga nacionale Tirane Bice, km 26 godine I kateshe nr 3rruga zhvillon aktivitetin e saj për një afat kohor të pacaktuar, duke filluar nga dita e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

**NENI 6**  
**Kapitali i Shoqërisë dhe Ortaket**

Kapitali i shoqërisë është në vlerën 100.000 (nje qind mijë) lek, Ortaket themelues z Bashkim Rrahmani , Z Flogert Rrahmani i dhe Z Hasan Rrahmanii te Shoqërisë Tregtare “**AGROTURIZEM RRAHMANI**” **SH.P.K** zotërojnë kuotat në këtë shoqëri si më poshtë:-**Z BASHKIM RRAHMANI**, shtetas Shqiptar i datëlindjes 01/10/1973 lindur në Tirane (Selbe), dhe banues në Tirane Dajt bizes



**Z, FLOGERT RRAHMANI**, shtetas shqiptar, i datëlindjes 26/01/1985, lindur në Tirane (Selbe), dhe banues në Tirane Dajt Selbe nd 0 mbajtës i kartes se identitetit me id I50126046P zotërues i l kuote l të përbërë nga 47000(dyqet e shtate mije) lek, duke përfaqësuar 47 %, të kapitalit.

**Z HASAN RRAHMANI**, shtetas Shqiptar i datëlindjes 31/12/1943 lindur në Tirane(Selbe), dhe banues në Tirane Dajt qafë Molle ndertesa 26 h l hyrja l mbajtës i kartes se identitetit me id E31231062V zotërues i l kuote l të përbërë nga 6000(gjashte mije) lek, duke përfaqësuar 6 %, të kapitalit.

Kapitali themeltar eshte shlyer plotesisht ne para nga Ortaket me themelimin e Shoqerise. Pergjegjesia e ortakeve shtrihet deri ne shumen e kontributeve te tyre ne kapitalin themeltar

#### **NENI 7** **Organet Drejtuese**

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

Asamblea e Përgjithshme e Ortakëve – organi më i lartë vendimarrës;

Administratori – organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

#### **NENI 8** **Administratori**

Shoqëria administrohet nga l Administratore i cili zgjidhet për një mandat pesë vjeçar me të drejtë rizgjedhje.

Administratori i shoqërisë do të jetë Znj Sara Rrahmani shtetas shqiptar i datelindjes 29/08/1999 lindur në Tirane Dajt Qafmollë BIZES 03900023, dhe banues në Tirane ,dajt qaf Molle bizes 03900023 nd 26 hyrja l mbajtës i Kartes se identitetit me ID J95829036N shtetas Shqiptar, Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administratori, te cili ushtronë këto të drejta në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjisllacionin në fuqi.

#### **NENI 10**

Ortakët themelues mund të vendosin me vullnetin e tyre, për pjesmarrjen në Shoqëri të tjera dhe të krijojnë çdo lloj aktiviteti tjetër privat, me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj.

#### **NENI 11**

Organizimi dhe funksionimi, i shoqërisë, ngritja e degëve apo filialeve të saj, do të bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës dhe statutit.

#### **NENI 12**

Ortakët detyrohen të ruajnë sekretin e themelimit dhe të veprimtarisë së Shoqërisë. Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhdëmtojnë Shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

#### **NENI 13**

Mosmarrveshjet për themelimin e Shoqërisë zgjidhen nga ortakët themelues dhe kur kjo nuk arrihet, ato zgjidhen nga Gjykata kompetente.

#### **NENI 14**

Akti i themelimit pasi u lexua nga Ortaket Themelues u gjet sipas vullnetit të tij dhe u nënshkruan pa urrejtje. Ky Akt-Themelimi hartohet në 3 kopje në gjuhën shqipe.

### **ORTAKET THEMELUES**

**Bashkim Rrahmani**

**Flogert Rrahmani**

**Hasan Rrahmani**

